

Vendim nr. 102 datë 15.05.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Genti Ibrahim, i,	Anëtar
Elsa Toska,	Anëtare

në datën 15.05.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 6 (F) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **FIQRI DEDJA**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 6135, datë 13.06.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 2423, datë 11.11.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2022-2983, datë 02.11.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: Nenet 42, pika 1, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Elsa Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Fiqri Dedja (*kërkuesi*) është një ndër trashëgimtarët ligjorë të Xhane Dedja (Eshja), trashëgimtare kjo e vetme ligjore e ish-pronarit Ramazan Eshja, e cila ka ndërruar jetë në datën 12.07.2008.

2. Kërkuesi dhe trashëgimtarët e tjerë kanë pretenduar pronësinë për një truall me sipërfaqe prej 18,200 m² të ndodhur në Hallias, Tiranë, për të cilën Xhane Dedja (Eshja) i është drejtuar fillimisht Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesë për vërtetimin e faktit juridik të përcaktimit të sipërfaqes dhe kufijve të ish-pronarit Ramazan Eshja.

3. Me vendimin nr. 3127, datë 18.06.2004, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: *“Pranimin e kërkesës së ngritur nga kërkuesja Xhane Dedja. Vërtetimin e faktit juridik të njohjes së ish pronarit Ramazan Eshja, për një pronë tokë e punuar me sipërfaqe 19.350 m², duke përcaktuar dhe kufizimet përkatëse nga Veriu me S.M., nga Lindja me pronën e H.Z., M.A. dhe S. e R.H., nga Jugu me O. e Xh.M., nga Perëndimi me S.T., rruga e kroit, të ndodhur në Hallias, Tiranë, pronë kjo e pasqyruar në skicën planimetrike bashkëlidhur aktit të ekspertimit të hartuar nga ekspertja E.A.”.*

4. Në vijim, bazuar në ligjin nr. 9235, datë 29.07.2004 *“Për kthimin dhe kompensimin e pronës” (ligji nr. 9235/2004)*, trashëgimtarët ligjorë të Ramazan Eshjas i janë drejtuar Komisionit Vendor të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të qarkut Tiranë (KVKKP) me kërkesë për kthimin e pronës. Me vendimin nr. 20, datë 14.10.2005 (*vendimi nr. 20/2005*), KVKKP-ja, Tiranë ka pranuar se prona figuron e regjistruar në zërin tokë bujqësore përpara Reformës Agrare të vitit 1946, sipas vërtetimit të seksionit të administrimit dhe mbrojtjes së tokës të qarkut Tiranë, se pronat e regjistruara në regjistrat kadastralë nuk kanë kufij të shënuar dhe se trashëgimtarëve ligjorë të Ramazan Eshjas u është njohur pronësia për pronën e pretenduar me vendimin nr. 3127, datë 18.06.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Megjithatë, në përfundim, ajo ka vendosur të mos shprehet deri në zgjidhjen në rrugë administrative dhe gjyqësore të problemit të mbivendosjes së krijuar, duke arsyetuar, ndër të tjera, se për këtë pronë komisionet e mëparshme, me vendimin nr. 28, datë 13.08.1999, kanë njohur pronarë familjen Cenoimeri, ndërsa me vendimin nr. 170, datë 13.04.2000 (*vendimi nr. 170/2000*), familjen Myderizi. Në këto kushte, ajo nuk mund të shprehej pa u zgjidhur më parë në rrugë administrative dhe gjyqësore mbivendosja e pronave të krijuara.

5. Me vendimin nr. 170/2000, KVKKP-ja, Tiranë ka vendosur: *“Të njohë ish-pronarë M., E., B., Y. dhe S. Myderizi (trashëgimtarët e tyre) në bazë të nenit 1 të ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993 mbi pronën e përbërë nga një copë tokë në Hallias me sipërfaqe 18.200 m². Kjo pronë kthehet e kompensohet si më poshtë: Truall i lirë me sipërfaqe të përgjithshme $S_L = 7000$ m² (sipas gentplanit bashkëngjitur) pjesa e vijëzuar dhe në bazë të nenit 19 të ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993 i kthehet pronarëve M., E., B., Y. dhe S. Myderizi (trashëgimtarët e tyre) pronësia mbi truallin e sipërpërmendur $S_L = 7000$ m². [...] Për pjesën tjetër të pronës prej*

11.000 m², problemi të zgjidhet gjyqësisht me familjen Cenoimeri, pasi kjo pronë i është njohur kësaj familje me vendimin nr. 28, datë 13.08.1999. [...] Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Rrethit Tiranë. Një kopje e këtij vendimi dërgohet për regjistrim në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme “Tirana I” sektori urban dhe një kopje i dërgohet Kadastrës Urbane.”.

6. Vendimi nr. 170/2000 i KVKKP-së, Tiranë, dhënë në favor të familjes Myderizi, është kundërshtuar gjyqësisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë edhe nga trashëgimtarët e S. Cenoimerit, të cilët pretendimet e tyre i kanë mbështetur në vendimin nr. 28, datë 13.08.1999 të KKKP-së, Tiranë. Me vendimin nr. 2746, datë 25.06.2002, gjykata ka vendosur: “*Rrëzimin e padisë së ngritur nga trashëgimtarët e familjes Cenoimeri si të pabazuar në prova dhe ligj. Pranimin e kundërpadisë të ngritur nga trashëgimtarët e familjes Myderizi, si të bazuar në prova dhe në ligj. Anulimin, shfuqizimin e vendimit nr. 28, datë 13.08.1999 të KKKP që është dhënë në favor të trashëgimtarëve të familjes Cenoimeri. Ndryshimin e pikës 1/b të vendimit nr. 170 datë 13.04.2000 që është dhënë në favor të trashëgimtarëve të familjes Myderizi, duke u kthyer këtyre të fundit (trashëgimtarëve Myderizi) sipërfaqen e truallit prej 11.000 m², brenda sipërfaqes prej 18.200 m² që komisioni u ka njohur si pronë të tyre, truall ky i ndodhur në sinorin Hallias të Qarkut Tiranë, me kufizimet përkatëse të përcaktuara në planimetrinë bashkëngjitur vendimit nr. 170, datë 13.04.2000 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë.*”. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 118, datë 30.01.2003 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

7. Kërkuesi së bashku me trashëgimtarët e tjerë kanë kundërshtuar në rrugë administrative vendimin nr. 20/2005 të KVKKP-së, Tiranë. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP), me vendimin nr. 201, datë 17.03.2008 (vendimi nr. 201/2008), ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të KVKKP-së, Tiranë, duke arsyetuar, ndër të tjera, se për këtë pronë nuk ka vetëm dy mbivendosje, por katër subjekte që pretendojnë të njëjtën pronë: familja Cenoimeri, familja Myderizi, Sh.Eshja dhe Xhane Dedja (Eshja). Për më tepër që për të njëjtën pronë pretendojnë dy subjekte: Xhane Dedja (Eshja) dhe Sh. Eshja, me të njëjtin mbiemër, por me pronar origjine të ndryshëm. Xhane Dedja (Esnja) e pretendon pronësinë nga Ramazan Eshja, kurse Sh.Eshja e pretendon pronësinë nga O.Eshja. Në asnjë nga dokumentet që ndodhen në dosjen në shqyrtim nuk gjendet asnjë material që të bëjë lidhjen mes dy subjekteve R. Eshja dhe O.Eshja. Po sipas AKKP-së, subjekti Fiqiri Dedja duhet që nëpërmjet rrugës gjyqësore të godasë të gjitha ato vendime të gjykatës, të cilat kanë krijuar mbivendosje me pronën që ai pretendon. Vetëm kështu ai do të fitojë të drejtën e pronësisë për

pronën, pasi këto vendime gjyqësore kanë marrë formë të prerë dhe AKKP-ja nuk mund të shfuqizojë një vendim gjyqësor.

8. Kërkuesi dhe bashkëtrashëgimtarët e tjerë i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi me objekt: *“Shfuqizimi i vendimit nr. 170, datë 13.04.2000 të KVKK Pronave Tiranë. Detyrimin e të paditurve të na njohin pronarë mbi një truall prej 18.200 m² të ndodhur në Hallias, Rr. “5 Maji”, Tiranë, regjistruar me nr. 106, datë 02.07.2004 në regjistrin hipotekor të ZVRPP Tiranë. Sigurimin e objektit të padisë. Detyrimi i ZVRPP Tiranë të mos kryejë veprime juridike mbi pasurinë e regjistruar me nr. 106, datë 02.07.2004 të regjistrin hipotekor”*, për të cilin gjykata, me vendimin nr. 9778, datë 13.11.2008, ka vendosur: *“Pushimin e gjykimit të çështjes civile me nr.7375 akti.”*.

9. Për ankimin e kërkuesit dhe të bashkëtrashëgimtarëve të tjerë, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 75, datë 03.03.2009, ka vendosur prishjen e vendimit civil nr. 9778, datë 13.11.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kthimin e çështjes për vazhdimin e gjykimit po në atë gjykatë.

10. Në vijim, me vendimin nr. 10016, datë 23.12.2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor. Për ankimin e veçantë të trashëgimtarëve Dedja, me vendimin nr. 00-2011-503 (105), datë 01.03.2011, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit nr. 10016, datë 23.12.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin e çështjes po asaj gjykate për vazhdimin e gjykimit.

11. Me vendimin nr. 6135, datë 13.06.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesës, duke arsyetuar, ndër të tjera, se kërkuesi dhe trashëgimtarët e tjerë nuk legjitimoheshin në ngritjen e padisë. Ata nuk kanë ankimuar në gjykatë, brenda afatit ligjor, vendimin nr. 201/2008 të AKKP-së, i cili ka marrë formë të prerë dhe nuk mund të kundërshtohet nga paditësit. Po sipas saj, prona e pretenduar nuk është shoqëruar me planvendosjen hartografike, kufijtë ose kufitarët, për rrjedhojë gjykata nuk mund ta pozicionojë atë në terren e të krijojë bindje për vendndodhjen e saj. Vendimi gjyqësor nr. 3127, datë 18.06.2004 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i paraqitur nga kërkuesi për përcaktimin e vendndodhjes dhe kufijve të pronës së pretenduar, ka efekte vetëm për të dhe trashëgimtarët e tjerë, paditës në gjykim, dhe nuk ka fuqi provuese kundër të paditurve Myderizi, si pronarë të pronës objekt gjykimi, të cilët nuk kanë qenë thirrur në gjykim dhe nuk kanë kundërshtuar gjatë gjykimit faktin e vërtetuar. Sipas gjykatës, vendimi nr. 170/2000 i KVKKP-së, Tiranë është i drejtë, i bazuar në ligj dhe në prova dhe duhet të lihet në fuqi. Ai ka marrë formë të prerë,

përbën titull ekzekutiv dhe prona është regjistruar në regjistrin hipotekor në emër të të paditurve Myderizi.

12. Kërkuesi dhe trashëgimtarët e tjerë kanë ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, duke kërkuar edhe riçeljen e hetimit gjyqësor edhe kryerjen e një hetimi të ri. Në lidhje me këtë kërkim, me vendim të ndërmjetëm, gjykata ka vendosur rrëzimin, duke e konsideruar aktin e ekspertimit të mjaftueshëm, pasi ekspertët kanë dhënë përgjigje për sa u është kërkuar. Gjykata e ka gjetur të gabuar trajtimin e vendimit nr. 201/2008 të AKKP-së si të formës së prerë nga gjykata e rrethit, duke argumentuar se ky vendim as ka pranuar e as ka rrëzuar pretendimet e kërkuesit dhe të trashëgimtarëve të tjerë. Në lidhje me pronën, gjykata e ka vlerësuar të drejtë qëndrimin e gjykatës së rrethit se pa planvendosje hartografike të pronës, pa kufij dhe kufitarë, nuk mund të krijohet bindja për vendndodhjen e saj. Për rrjedhojë, sipas gjykatës, në kushtet kur përcaktuese për çështjen e të qenit pronar janë dokumentet e secilës palë, me të drejtë gjykata e rrethit ka krijuar bindjen se prona është e të paditurve. Në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. 2423, datë 11.11.2013, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 6135, datë 13.06.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

13. Në datën 09.12.2013 kërkuesi dhe bashkëtrashëgimtarët e tjerë Dedja i janë drejtuar me rekurs Gjykatës së Lartë. Me vendimin e datës 24.11.2016, Kolegji Civil i kësaj gjykate ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore, ndërsa me vendimin e datës 17.10.2022 ka vendosur revokimin e vendimit për shqyrtimin e çështjes civile nr. 11111-00030-00-2014 të regjistrit themeltar në seancë gjyqësore dhe kthimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore mbi bazë të dokumenteve; thirrjen në këtë gjykim në cilësinë e paditur Agjencinë e Trajtimit të Pronave në vend të AKKP-së, Tiranë; caktimin e shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit më 02.11.2022; urdhërimin e sekretarisë së gjykatës të bëjë njoftimin e palëve për orën dhe ditën e caktuar për shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit, si dhe për depozitimin brenda 15 ditëve të parashtrimeve me shkrim prej tyre, në çdo rast jo më vonë se 5 ditë përpara datës së seancës.

14. Në datën 25.10.2022 subjektet e paditura Myderizi kanë paraqitur shpjegime për çështjen. Në vijim, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-2983, datë 02.11.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit.

15. Në datën 01.03.2023 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë për shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve të lartpërmendura, duke pretenduar se i kanë cenuar të drejta kushtetuese.

II

Pretendimet e kërkuessit

16. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmblodhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

16.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, në drejtim të:

16.1.1. *Parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj*, për shkak të revokimit nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë të vendimit të tij të mëparshëm për gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore dhe zhvillimit të gjykimit në dhomën e këshillimit, mbi bazë të dokumenteve, ndërkohë që Kolegji Civil fillestar i Gjykatës së Lartë kishte vendosur kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, për shkak se kishte konstatuar shkelje të rënda procedurale dhe mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit.

16.1.2. *Parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme*, pasi vendimet nr. 10016, datë 23.12.2010 dhe nr. 6135, datë 13.06.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë janë dhënë nga i njëjti trup gjyqësor.

16.1.3. *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi gjykata e rrethit dhe gjykata e apelit i kanë mohuar të drejtën për të paraqitur prova me ekspert, duke e vendosur në kushte pabarazie me palën tjetër. Gjykata e rrethit nuk ka marrë parasysh aktin e ekspertimit të hartuar nga E.L. dhe nuk ka pranuar grup ekspertësh të tjerë ose ekspertizë shtesë për paqartësitë e konstatuara në aktin e ekspertimit. Edhe në aktin e ekspertimit të paraqitur nga të paditurit nuk rezulton asnjë hartë ose skicë arkivore, çka tregon se gjykata mbivlerëson një akt ekspertimi në raport me një tjetër.

16.1.4. *Së drejtës për mbrojtje efektive*, pasi Gjykata e Lartë nuk i ka vënë në dispozicion shpjegimet dhe provat e datës 25.10.2022 të paraqitura nga subjektet e paditura Myderizi.

16.1.5. *Standardit të arsytimit të vendimit*, pasi arsyetimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përmes të cilit prona i njihet dhe i mohohet njëkohësisht, është alogjik, joligjor dhe jo kushtetues. Gjykatat nuk u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të tij, veçanërisht në lidhje me aktet e ekspertimit dhe origjinën e pronës, si dhe nuk kanë arsyetuar për provat ku bazoheshin ato.

16.1.6. *Standardit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm*, pasi Gjykata e Lartë fillimisht ka marrë në shqyrtim rekursin në vitin 2016, duke e kaluar

çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore, ndërsa vendimi për çështjen është dhënë pas 6 vjetësh.

16.2. *E drejta e pronës*, pasi, nga njëra anë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ia njeh këtë të drejtë, ndërsa nga ana tjetër ia mohon atë, për shkak të mospërcaktimit të pozicionimit të pronës. Për origjinën e pronës së pretenduar nga të paditurit në gjykimin e zakonshëm janë dhënë tre vendime të ndryshme nga KVKKP-ja, Tiranë dhe gjykatat. Gjykata e Apelit Tiranë, në mënyrë të pabazuar, nuk ka pranuar kërkesën për riçelje të shqyrtimit gjyqësor, për thirrje të ekspertëve të tjerë, si dhe për sqarimin e pyetjeve dhe çështjeve, për të cilat kërkohen njohuri të posaçme.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkesit

17. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

18. Kërkuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor, ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

19. Lidhur me kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive, në praktikën e saj Gjykata ka pranuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, kërkuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të

disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve juridike efektive përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili përpara se t'i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura (*shih vendimet nr. 12, datë 24.05.2022; nr. 15, datë 11.03.2021; nr. 38, datë 25.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në drejtim të vlerësimit të këtij kriteri, në rastin konkret, Kolegji konstaton se pretendimin për cenimin e standardit të gjyimit brenda një afati të arsyeshëm kërkuesi e ka parashtruar drejtpërdrejt përpara Gjykatës. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se si rregull, shqyrtimi i këtyre lloj çështjesh dhe vlerësimi përfundimtar në lidhje me kohëzgjatjen e arsyeshme të gjyimit, sipas neneve 399/1 – 399/12 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), duhet të bëhet nga gjykatat e zakonshme, sipas kompetencës që parashikon KPC-ja, në përputhje me parimin e subsidiaritetit (*shih vendimet nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, pretendimet për paanshmërinë e trupit gjykues të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk rezultojnë të jenë ngritur nga kërkuesi në ankim ose rekurs. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se ai nuk legjitimohet në ankimin kushtetues individual në lidhje me këto pretendime, pasi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t'i drejtohet Gjykatës.

21. Për sa u përket pretendimeve për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit, Kolegji vëren se ato kanë të bëjnë me të drejtën e pronës, e cila qëndron në thelb të kërtimeve të tij gjatë procesit gjyqësor. Po kështu, pretendimet për cenimin e parimit të gjyimit nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe të së drejtës për mbrojtje efektive, kanë të bëjnë me vendimin e Gjykatës së Lartë, i cili ka përmbyllur procesin në gjykatat e zakonshme. Për rrjedhojë, në lidhje me këto pretendime, Kolegji çmon se kërkuesi i ka shteruar mjetet juridike efektive përpara se t'i drejtohet Gjykatës.

22. Për sa i takon legjitimitet *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Kolegji vëren se vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 02.11.2022, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 01.03.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

23. Në lidhje me legjitimitetin *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të parimit të gjyimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, cenimin e së drejtës për mbrojtje efektive e të standardit të arsyetimit të vendimit, si dhe cenimin e së drejtës së pronës.

24. Në lidhje me pretendimet për cenimiin e së drejtës për mbrojtje efektive, për shkak se shpjegimet dhe provat e datës 25.10.2022 drejtuar Gjykatës së Lartë, të paraqitura nga pala e paditur nuk i janë vënë në dispozicion, nga materialet e depozituara së bashku me kërkesën, Kolegji vëren se pavarësisht se është njoftuar për vendimin e revokimit të Gjykatës së Lartë, kërkuuesi nuk ka paraqitur parashtrime me shkrim, ndërkohë që kanë parashtruar shpjegime subjektet e interesuara Myderizi. Në kushtet kur rekursi është paraqitur në Gjykatën e Lartë nga kërkuuesi dhe trashëgimtarët e tjerë, Kolegji çmon se ky pretendim nuk është ngritur në nivel kushtetues, pasi nuk është përcaktuar shkelja reale e të drejtave, si rrjedhojë e mosvënies në dispozicion të pretendimeve të palëve të paditura të datës 25.10.2022.

25. Në vijim, Kolegji çmon të analizojë pretendimet e kërkuetit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, si dhe të së drejtës së pronës në lidhje me arsyetimin e vendimit, të cilat, *prima facie* përfshihen në juridiksionin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj

26. Kërkuuesi ka pretenduar se i është cenuar parimi i gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, për shkak të revokimit nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë të vendimit të tij të mëparshëm për gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore dhe zhvillimit të gjykimit në dhomën e këshillimit, mbi bazë të dokumenteve, ndërkohë që Kolegji Civil fillestar i Gjykatës së Lartë kishte vendosur kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, për shkak se kishte konstatuar shkelje të rënda procedurale dhe mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit.

27. Gjykata ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e caktuar me ligj është një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, i sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*). Në jurisprudencën kushtetuese ky parim është trajtuar i lidhur me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi, të cilat duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre, gjatë një procesi të zhvilluar sipas një procedure ligjërish të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. Gjithashtu, këtë parim Gjykata e ka parë të lidhur ngushtë edhe me përbërjen e trupit gjykues të ngarkuar për shqyrtimin e çdo çështjeje konkrete (*shih vendimin nr. 15, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Për sa i takon zbatimit në kohë të ligjit, Gjykata është shprehur se në të drejtën procedurale, ndryshe nga ajo materiale, ligji i ri ka fuqi edhe për çështjet që janë në gjykim, me përjashtim të rastit kur vetë ai shprehet ndryshe (*shih vendimet nr. 3, datë 11.02.2021; nr.*

11, datë 23.04.2009 të Gjykatës Kushtetuese). Në kuadër të ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore të vitit 2016 në lidhje me kompetencat e reja të Gjykatës së Lartë, në datën 23.03.2021 ligjvënësi ka miratuar ligjin nr. 44/2021, i cili ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Përmes këtij ligji janë përcaktuar rregulla të reja procedurale në lidhje me shqyrtimin e çështjes në Gjykatën e Lartë, sipas nenit 482 të KPC-së, i cili tashmë, si rregull, bëhet mbi bazë të dokumenteve në dhomën e këshillimit. Këto dispozita kanë karakter procedural dhe, përveç rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe, zbatohen në përputhje me parimin *tempus regit processum* edhe për çështjet që janë në gjykim.

29. Duke iu rikthyer rastit konkret, Kolegji vëren se gjatë gjykimit të çështjes së kërkuarit mbi bazë të dokumenteve në dhomën e këshillimit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vepruar në përputhje me kompetencat e tij ligjore dhe një veprim i tillë nuk rezulton në shkelje të parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj. Nga ana tjetër, nga materialet e vëna në dispozicion nga kërkuari, Kolegji konstaton se me shkresën e datës 17.10.2022 të Gjykatës së Lartë ai është njoftuar për revokimin e vendimit datë 24.11.2016 për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore dhe gjykimin e saj në dhomën e këshillimit pa praninë e palëve, në datën 02.11.2022, si dhe për të drejtën për të paraqitur pretendime me shkrim. Ndonëse ka marrë dijeni për ndryshimin e mënyrës së gjykimit të rekursit të tij dhe i është dhënë mundësia të parashtronte pretendimet me natyrë kushtetuese ndaj vendimit të ndërmjetëm, kërkuari nuk rezulton ta ketë shfrytëzuar këtë mjet juridik.

30. Për sa më lart, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuarit për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj është haptazi i pabazuar.

C. Për pretendimin për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit

31. Kërkuari ka pretenduar se gjykata e rrethit dhe gjykata e apelit i kanë mohuar të drejtën për të paraqitur prova me ekspert, duke e vendosur në kushte pabarazie me palën tjetër. Gjykata e rrethit nuk ka marrë parasysh aktin e ekspertimit të hartuar nga E.L. dhe nuk ka pranuar grup ekspertësh të tjerë ose ekspertizë shtesë për paqartësitë e konstatuara në aktin e ekspertimit. Edhe në aktin e ekspertimit të paraqitur nga të paditurit nuk rezulton asnjë hartë ose skicë arkivore, çka tregon se gjykata mbivlerëson një akt ekspertimi në raport me një tjetër.

32. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes tyre. E

drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t'u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit civil, por duhet që legjislacioni procedural, në radhë të parë, dhe, më pas, gjyqtari gjatë gjykimit, t'u japin mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Nëse nuk do të ekzistonte parimi i barazisë së armëve, atëherë argumentet e njërës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar, për rrjedhojë e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Bazuar në këto parime, Gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve ose përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimet 13, datë 21.03.2023; nr. 41, datë 22.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Në rastin konkret, Kolegji vëren se vendimi nr. 3127, datë 18.06.2004 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për vërtetimin e faktit juridik të përcaktimit të sipërfaqes dhe kufijve të pronës së trashëgimtarëve Dedja është bazuar në vërtetimin e pronësisë së Ramazan Eshjas të lëshuar nga zyra e kadastrës, Tiranë, dokumentet e nxjerra nga Arkivi i Shtetit, si dhe në gjetjet e ekspertës E.A., të caktuar nga gjykata. Ndërkohë, gjatë gjykimit të çështjes së iniciuar nga këta trashëgimtarë për kundërshtimin e vendimit nr. 170/2000 të KVKKP-së, Tiranë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vlerësuar se vendimi i saj për vërtetimin e faktit juridik nuk ka fuqi provuese kundër të paditurve Myderizi, pasi këta të fundit nuk kanë qenë të thirrur në këtë gjykim. Për më tepër, ata kanë paraqitur si provë aktin e ekspertimit të ekspertëve H.D. dhe A.Ll., të bërë me kërkesë të organit të prokurorisë, përmes të cilit akti i ekspertimit i ekspertës E.A. është nxjerrë i rremë. Po sipas gjykatës, bazuar në aktin e ekspertimit të marrë si provë në gjykim, prona e palës së paditur Myderizi, e trajtuar me vendimin nr. 170/2000 të KVKKP-së, Tiranë, është pozicionuar qartë në terren e në planvendosje të aktit të ekspertimit, ndërkohë që për pronën e pretenduar nga kërkuesi dhe trashëgimtarët e tjerë, në dokumentet e pronësisë të paraqitura mungojnë planvendosja, të dhënat për kufijtë dhe kufitarët e saj, si dhe elementët e tjerë teknikë (*shih vendimin nr. 6135, datë 13.06.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, faqet 12-13*). Në përfundim, me vendimin nr. 6138, datë 13.06.2012, gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së kërkuesve.

34. Gjatë gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit, kërkuesit kanë kërkuar riçeljen e hetimit gjyqësor dhe kryerjen e një ekspertimi të ri, duke pretenduar se ekspertët nuk kanë bërë detyrën e tyre, nuk u janë përgjigjur pyetjeve të gjykatës, si dhe nuk kanë arritur të pozicionojnë

pronën. Me vendim të ndërmjetëm, gjykata e apelit ka vendosur rrëzimin e kësaj kërkesë, duke vlerësuar se akti i ekspertimit i ekspertëve H.D. dhe A.L. ishte i mjaftueshëm dhe kishte dhënë përgjigje për sa ishte kërkuar. Po sipas gjykatës, ekspertët kanë pasur në dispozicion nga paditësit vetëm dokumente për një sipërfaqe toke pa kufij të përcaktuar dhe, me të drejtë, në këtë gjendje të provave, ata e kanë pasur të pamundur të pozicionojnë pronën e tyre, ndërkohë që e kanë pasur të lehtë të pozicionojnë pronën e të paditurve, pasi dokumentacioni ka qenë i plotë (*shih vendimin nr. 2423, datë 11.11.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë, faqja 11*).

35. Pretendimet e trashëgimtarëve Dedja për gjetjet e aktit të ekspertimit janë parashtruar edhe në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë. Kjo e fundit, në vendimin e saj ka arsyetuar se pjesa e pretendimeve në rekurs që ngre çështje të vlerësimit të provave del jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të saj, dhe se nëpërmjet rekursit nuk mund të pretendohet të rihapet edhe një herë shqyrtimi gjyqësor i provave. Po sipas Gjykatës së Lartë, ushtrimi i kontrollit rishikues të saj nuk mund të konsistojë në një rivlerësim të provave në të kundërt me atë që kanë bërë gjykatat e faktit, për shkak se një rivlerësim i tillë bie ndesh me vetë natyrën e gjykimit të saj (*shih vendimin nr. 00-2022-2983, datë 02.11.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*).

36. Në këndvështrim të sa më lart, Kolegji vëren se pretendimet e kërkuarit, si një nga trashëgimtarët Dedja gjatë procesit gjyqësor, janë marrë në shqyrtim nga gjykatat, duke iu dhënë përgjigje të argumentuar, për sa u përket gjetjeve në aktin e ekspertimit dhe vlerësimit të tyre nga gjykatat. Në analizë të vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme rezulton se atij i është dhënë mundësia të deklarojë për faktet dhe provat në thelb të gjykimit, si dhe t'i kundërshtojë ato, ndërkohë që gjykatat kanë vënë në balancë faktet dhe provat e paraqitura në gjykim nga trashëgimtarët Dedja përkundrejt atyre të paraqitura nga palët e paditura. Në rastin konkret, Kolegji vlerëson se kërkuari nuk rezulton të jetë vënë në kushte të pabarabarta me palët kundërshtare dhe këta të fundit nuk rezulton të jenë avantazhuar në paraqitjen e pretendimeve të tyre.

37. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se pretendimet e kërkuarit për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit janë haptazi të pabazuara.

Ç. Për pretendimin për cenimin e së drejtës së pronës në lidhje me standardin e arsyetimit të vendimit

38. Kërkuari ka pretenduar se, nga njëra anë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë i njeh të drejtën e pronësisë për pronën, ndërsa, nga ana tjetër, ia mophon këtë të drejtë për shkak të

mospërcaktimit të pozicionimit të saj. Për origjinën e pronës së pretenduar nga të paditurit në gjykimin e zakonshëm janë dhënë tre vendime të ndryshme nga KVKKP-ja, Tiranë dhe gjykatat. Gjykata e Apelit Tiranë, në mënyrë të pabazuar, nuk ka pranuar kërkesën për riçelje të shqyrtimit gjyqësor, për thirrje të ekspertëve të tjerë, si dhe për sqarimin e pyetjeve dhe çështjeve, për të cilat kërkohen njohuri të posaçme. Gjykatat nuk u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të tij, veçanërisht në lidhje me aktet e ekspertimit dhe origjinën e pronës, si dhe nuk kanë arsyetuar për provat ku bazoheshin ato.

39. Neni 41 i Kushtetutës garanton të drejtën e pronës private (*pika 1*), duke parashikuar, ndër të tjera, se ligji mund të parashikojë kufizime në ushtrimin e kësaj të drejte vetëm për interesa publikë (*pika 3*) dhe se kufizimet lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë (*pika 4*), për masën e të cilit mund të bëhet ankim në gjykatë (*pika 5*). Kriteret që parashikon neni 41 i Kushtetutës, që janë garantimi i pronës private dhe shpërblimi i drejtë, si dhe koncepti i përcaktuar nga KEDNJ-ja për gëzimin e pronës në mënyrë të qetë, janë orientimet bazë mbi të cilat duhet të zgjidhen të gjitha çështjet që lidhen me shpronësimet dhe kufizimet e pronës (*shih vendimet nr. 43, datë 27.12.2022; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 4, datë 15.02.2021; nr. 30, datë 01.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Në një shtet demokratik individit duhet t'i garantohet gëzimi i qetë dhe pa pengesa të paarsyeshme ose joproporcionale i së drejtës së pronës. Megjithatë, me gjithë mbrojtjen që ajo gëzon, e drejta e pronës mund t'i nënshtrohet kufizimeve, të cilat duhen bërë sipas disa kriterëve të përcaktuara në mënyrë shteruese në nenin 17 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 43, datë 27.12.2022; nr. 15, datë 22.06.2022; nr. 25, datë 28.04.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

40. Në rastin konkret, Kolegji vëren se, në thelb, kërkuesi ka pretenduar se në procesin e kundërshtuar gjykatat i kanë mohuar të drejtën e pronës, duke parashtruar se ato nuk kanë arritur të përcaktojnë pozicionimin e saj, ndërkohë që ajo u është dhënë në mënyrë të padrejtë individëve të tjerë. Po sipas tij, në drejtim të realizimit të kësaj të drejte, Gjykata e Apelit Tiranë nuk ka pranuar kërkesën për riçelje të shqyrtimit gjyqësor, për thirrje të ekspertëve të tjerë, si dhe për sqarimin e pyetjeve dhe çështjeve, për të cilat kërkohen njohuri të posaçme.

41. Në analizë të vendimmarrjes së gjykatave, Kolegji vëren se në vendimin nr. 6135, datë 13.06.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka pranuar se trashëgimlënësi i kërkuesve Ramazan Eshja ka pasur në pronësi 15 dynymë tokë, por ka vlerësuar se vendimi i saj nr. 3127, datë 18.06.2004, për vërtetimin e faktit juridik të përcaktimit të sipërfaqes dhe kufijve të pronës së trashëgimtarëve Dedja kishte efekte vetëm për ta dhe jo për subjektet Myderizi, pasi këta të fundit nuk ishin thirrur në gjykim dhe nuk e kishin kundërshtuar këtë akt gjatë gjykimit. Sipas

saj, vendimi i vërtetimit të faktit juridik ka pozicionuar një pronë me 19.350 m² me kufizime të përcaktuara, por nga krahasimi i kufijve të përcaktuar në këtë vendim me terrenin, kjo sipërfaqe futet brenda familjes Myderizi me sip.18.000 m² dhe brenda pronës së familjes H.K. me sipërfaqe 2000 m², prona këto me dokumente hipotekore dhe të regjistruara në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurisë, Tiranë. Po sipas gjykatës, prona e palës së paditur Myderizi, e trajtuar me vendimin nr. 170/2000 të KKKP-së, Tiranë, është pozicionuar qartë në terren e në planvendosje të aktit të ekspertimit, ndërkohë që për pronën e pretenduar nga kërkuesi dhe trashëgimtarët e tjerë, në dokumentet e pronësisë të paraqitura mungojnë planvendosja, të dhënat për kufijtë dhe kufitarët e saj, si dhe elementet e tjera teknike (*shih vendimin nr. 6135, datë 13.06.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, faqet 13-14*).

42. Në vendimin nr. 2423, datë 11.11.2013, Gjykata e Apelit Tiranë e ka gjetur të drejtë vlerësimin e gjykatës së rrethit, për sa i përket pronësisë së trashëgimtarëve Myderizi, duke arsyetuar në të njëjtën mënyrë me gjykatën e rrethit. Edhe sipas kësaj gjykate, vërtetimi kadastral i paraqitur nga kërkuesit nuk ishte shoqëruar me planvendosjen hartografike dhe nuk kishte të përcaktuar kufijtë e kufitarët, për rrjedhojë ekspertët e kanë pasur të pamundur të pozicionojnë në terren pronën e trashëgimtarëve Dedja, në ndryshim nga prona prej 18.000 m² e të paditurve të familjes Myderizi, e cila ishte e pozicionuar qartë në terren (*shih vendimin nr. 2423, datë 11.11.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë, faqja 11*).

43. Kolegji vëren, gjithashtu, se pretendimet e ngritura në rekurs nga kërkuesi dhe trashëgimtarët e tjerë në lidhje me këtë gjykim janë marrë në shqyrtim në dhomën e këshillimit nga Gjykata e Lartë, i cila ka vlerësuar se rekursi është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato të përcaktuara në nenin 472 të KPC-së, sipas formulimit të kësaj dispozite në kohën e paraqitjes së tij. Po sipas gjetjeve të kësaj gjykate, në gjykim nuk ishin lejuar shkelje procedurale që do të bënin të pavlefshëm procesin dhe do të ndikonin në vendimmarrjen e gjykatave; gjykatat më të ulëta kanë respektuar ligjin material, duke e interpretuar dhe zbatuar drejt atë; vendimet e tyre nuk janë në kundërshtim me ndonjë vendim të Kolegjit Civil të saj ose të Kolegjeve të Bashkuara. Për sa u takon pretendimeve në rekurs që ngrinin çështje të vlerësimit të provave, gjykata ka vlerësuar se ato dilnin jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të saj (*shih vendimin nr. 00-2022-293, datë 02.11.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, faqja 15, paragrafët 21- 22*).

44. Në këndvështrim të sa më lart, Kolegji thekson se vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe interpretimi i ligjit, janë kompetenca të gjykatave të sistemit gjyqësor të zakonshëm dhe, si të tilla, nuk mund të jenë objekt i gjykimit kushtetues. Gjykata ka në

kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes. Në këtë kuptim, problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit mund të merren në konsideratë vetëm nëse përmes këtij procesi cenohen të drejta ose liri kushtetuese themelore, raste në të cilat Gjykata bën një vlerësim të natyrës kushtetuese, që dallon nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimin nr. 41, datë 22.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

45. Në çështjen në shqyrtim, Kolegji vëren se pretendimet e kërkuarit për cenimin e të drejtës së pronës në lidhje me standardin e arsytimit të vendimit kanë të bëjnë, në thelb, me vlerësimin e fakteve dhe rrethanave të çështjes, çka nuk përfshihet në juridiksionin e Gjykatës. Nga ana tjetër, Kolegji vlerëson se interpretimi që gjykatat e juridiksionit të zakonshëm i kanë bërë legjislacionit në fuqi dhe zbatimit të tij në rastin në shqyrtim nuk rezulton të jetë arbitrar dhe nuk shfaq probleme në aspektin kushtetues, të tilla që do të kërkonin ndërhyrjen e Gjykatës. Në analizë të vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme, rezulton se ato u kanë dhënë përgjigje të argumentuar pretendimeve të kërkuarit, si për të drejtën e pronës, ashtu edhe për aktin e ekspertimit në drejtim të vlerësimit të kësaj të drejte (*shih paragrafët 33-36 të vendimit*). Vendimet e tyre nuk rezultojnë të jenë të paqarta, alogjike ose në mungesë të elementeve formale, për rrjedhojë pretendimi i kërkuarit për cenimin e të drejtës së pronës në lidhje me standardin e arsytimit të vendimit është haptazi i pabazuar.

46. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31, dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.